

Gjon Marka Gjoni

Kapidan'i Mirditës

nga ERNEST KOLIQI

Rrallë njeri në breznit e fundit paraqitej ndër në si Gjon Marka Gjoni i ngjeshun me tharmet më dalluese të brumit t'onë etnik. Në shoqëri të tij, tue i a ndëgjue kuvendin, kishim përshtypjen se gjindemi para prototypit të racës shqiptare shpëtue për mrekulli nga cënimi i kohës. Si një avull legendash e rrethonte. Edhe, n'at avull ku vrumulishin mysteret e historisë s'onë plot tërnim periudhash t'errta, Ai, i thjeshtë në sjellje, i përkuerm në fjalë, i ngulun në besim qi ushqente në vlerën e përvojës stërgjyshore, — e vetmja kulturë e tij, nxjerrë nga libri i jetës dhe jo nga jeta e librave —, t'epte bindjen se rodi i ynë, pak i njoftun e shpesh i përçmuem, përmbledh në vetvete ende vërtyte njerzore të pazbulueme. Qindresa në fatkeqsit shtëpijake, matunija në gjikime të njerzvet qi dojshin t'a shofin të hupun, stoicizmi me të cilin barti vuetjet e smundjes së gjatë dishmojshin haptas rrjedhjen e Tij nga një fis trim e zëmërmadh dhe rritjen në një frymë të trashigueme kreshnikije. Shka në shumë prej nesh shfaqej si veti burrnore e rrallë, në Të dukej gjatë krejt e rendomtë. Gitej, në të pamit e parë, njeri ftyrë-vrântë e i ngurtë, por nën at qindrim mbulonte ndiesi të buta e mirsi të thellë.

Këtij prisi trimash qi nuk derdhi pikë loti mbi tragjedin e të bijvet, i a rinte s'yt me vāj humbja e një miku. Përmbante të ndrëme në zëmër dashunin më të nxehtë shtëpijake, jo nga ftoftësija ase pandieshmenija e natyrës (tabjatit), por pse mbas mendësis së malcive, ai lloj të prumi u kishte hije burrave. Sedra për Të kishte randësi aq sa jeta e më tepër.

Jetën e përftonte si mbas frymës së *Kanûnit*, kodi moral e shoqnuer i Shqiptarvet, qi Ai me të drejtë gojdhânore ruente e, kur e lypte nevoja, interpretonte e zbatonte. Normat kanûnore i kishte të skalituna në mbamendje. Ai besonte në fisnikë t'atye ligjvet dokesore dhe kurrnji dyshim nuk i a lodhte menden mbi vlerën e përjetëshme t'udhëzimeve përmbledhë n'ato norma të lashta. Kod i burrnis, i nderit, i mikpritjes, — përmbatje heroike e dënjë me ushqye mende e zëmra fatosash — undyrë njerzore qi bujarson jetën. Kush ndjek në jetë ato parime mund të dali para botës mbarë me ball të haptë. Kjo bindja e Tij.

Rojtar i *Kanûnit*, jetoj deri në vdekje i kredhun shpirtnisht në ndienja lashtësije epike, tue njehë zvetnim shka nuk përkonte me këto.

Qe një ndër përfaqësues të fundit të asaj Shqipërie që kapërcei anames rrebesheve të historisë, e ngujueme në doke stërgjyshore, të cilat e ndihmuen më së rrejtë të papeçatun fizjonomi etnike.

Besoi gëlltisht në Perëndinë, në prorrinë njerzore e në aftësinë mbarshpues të Kanunit, në kreninë e emnit shqiptar dhe në të drejtën e prijës që kish trashigë prej të parve.

JETA

Kapidan Gjoni lindi në Orosh të Mirditës më 28 gusht 1888. I ati Marka Gjoni ishte nip i Lleshit të Zë, që pat emën të madh në Shqipëri e në Ballkan kah gjymja e parë e XIX qindvjet. Si mbas zakonisht që ruhet djallë mbas djali në Derë të Gjomarkajvet, sa është gjallë prindi, të bijvet u përket me i u shtrë vullnesës atnore dhe me i a ndjekë urdhin si ushtarë. Kjo s'është me thënë se prindi nuk këshillohej me djelm, por tregon dishiplinën e fortë e nderimin e madh për Prindin-pris të cilit vetëm i ndëgjohej zëni në votër shtëpijake.

Të diellën e Pashkëve më 1925 vdiq Kapidan Marka Gjoni, mbas një jete plot peripetia përshkrue edhe nga Faik Konica në të përshkrahjen « Albania ». I xanun befas prej Turkoshakve ashtu si kushtrini Preng Bib Doda e si Hodo beg Kopliku, u internue në Anadolli. Malli i atdheut e shporonte aq fort në at mërgim saqi vendosi me këthye, dalë ku të dalë. Pa dijtë gjuhë e pa mjete, iku e u përshkue nëpër Rusi, Poloni, Austri e arriti në Mirditë, ku autoritetet otomane nuk guxuen më të trazue. Më 1914 rrëni me Mirditas në Durrës për të mprojtë Mbretin Wied. Ngjitas me Kosovaret e Isa Boletinit djelm e Mirditës ranë në luftime të rrepta kundër kryengritësve që dojshin të ndalojnë mëmbjen e një shteti shqiptar të pamvarun. Humbjet qenë të mëdha.

Si vdiq i ati, Kapidan Gjoni i doli prirja e i u ngarkue përgjegjësi me udhëheqje Mirditën, si mbas tagrit historik të Derës së Gjomarkajvet.

Ai i u përvesh zyrës së vet me at tubë mendimesh të qarta e me vendosmërinë që përhera e dalloj kur u lyp në rasi të ndryshme ndërhyrja e tij, në datsh si gjyqtar gojdhauer i pranuem vullnetarisht nga populli e në datsh si pris luftarak i caktuem nga e drejta kanunore.

Më 1926 doli nëpër bajrakë të Mirditës me ushtrinë të parën zabitname të Tij. Tue kryesue Krenër e sejcilit bajrak pajtoi në at vjet 364 gjaqe e varrë. Ata që nuk njohin zakonet e malevet (mjerisht numri i tyre është bukur i madh) duhet të vëhen në dijeninë se gjaqet, ky zakon — që mund të ligjohej disa kur malet nën sovranitetin nominal të Sulltanit gëzojshin autonomi të plotë dhe, në mungesë të një organi ligjvënës të normave dokesore, sejcili ishte i lëjuem me zbatue vetë dënimet e parapamë prej Kanunit, — ky zakon dëmtonte keqas zonat malore të onat: duhej shpërndosë. Kapidan Gjoni, në marreveshtje me qeverinë qandore, u përpoq sa mujt me shafitë ngatrrësa e fitme që më të shumtën përfundojshin në vrasje.

Me 1928 nëpër Mirditë ushtroi të dytën zabitname tue pajtue 258 gjaqe e varrë. Kjo e zabitnames ishte si një misjon i jashtazakonshëm që përsritej krye tri katër vjetësh, por detyrën e pleqnimeve me ujdise kalla e ngatrrisa të vjetra e të reja e ushtronte pajadë në Kulla të veta n'Orosh. Dera e Tij rrinte haptë për të gjithë ata që kishin ndoj rragatje me ndreqë. Pleqnimet i bante falas.

Dera e Gjomarkajvet ka pasë juridikcion të drejtpërdrejtshëm prisiqe luftarake në Bajrakë të Mirditës, porse tërthorazi influksi i saj moral shtrihej gjatë nëpër vise të Veriut të Shqipërisë. Kush nuk u ndreqte me pleq vendas, i a mshinte Gjomarkajve për me zgjidhë davat. Shpesh nga Mati, Dibra, Luma e Kosova vijshin njerzija në Derë të Kapidanavet për me gjetë godi në çashtje të koklavituna. Kapidan Gjoni urtisht e drejtësisht shuente me vendime të paanëshme pamarrëveshtje e grindje. Vendimi i shqyptuem prej Kapidanit pranohej pa fjalë prej palve në kundërshtim. Mospranimi shkaktonte kori. Burrat i u shtrojshin gjikimevet, të magjepsun nga lashtësia e madhnueshme e normavet kanunore që Kapidani dinte të zbatonte me mend e me vend.

Deri vonë është përmendë në Veri të Shqipërisë ndamja e Shtëpisë së Qarrajvet të Hasit që rreth vjetve 1934-35 kreu Kapidani, mbasi pleq e njerz t'urtë më kot ishin përpjekë me i a gjetë asaj ndamjeje mënyrën e fijen. Ishte ajo e Qarrajvet një familje me 120 e sa pjestarë dhe e pajisun me një pasunë të madhe: pare, ndertesa, bashtina, kulllosa, gjatë të gjallë etj. Ndau pasunin Kapidani edhe pasojat e vrasjevet, d.m.th. për këto të mbramet tregoi si me të holla e me ndërmjetësi miqësh mund të ndreqeshin gjaqet e varrët bënë e pësue nga ajo shtëpi. Erdhen për këtë ndamje tridhetë burra nga Hasi e bújten me javë n'Orosh. Duelen tue i urue Kapidanit jetë të gjatë e shëndet.

Një tjetër ujdë që në ditë të veta bëni bujë që ajo katundit Domgjon të Fandit me Bajrakun e Malitzi të Pukës. Kapë ndër veti për punë të kufijve, Kapidan Gjoni i ndreqi e i miqasoi shi kur, acarue fjalët ndër veti, pregatiteshin të zgjidhin davan me pushkë.

Mos të mendohen marrëdhënjet e Kapidanit me Mirditas si një lidhje në mes një eprori absolut e gregarvet verbënisht të shtruem në ndigjesë t'urdhnavet të Tija. Në, që patëm rasë t'a njohim mirë, kurr s'na ka rënë në sy asnjë shëj servilizmi në sjellje të Mirditasvet kundruell Kapidanit. As ky nuk mirrte kurr qindrim dispotik kundruell tyne. Ata nderojshin në të mishnimin e traditës, pranojshin me vullnet të plotë prijen e Tij shugurue prej një ushtrimi qindvjeçar. Ndër Mirditas kishte shtëpia më të pasuna se Dera e Gjomarkajvet. Kjo mbante eprorin mbi Krenë e mbi popullsi veç me auktoritet moral.

Titullin « princ » me të cilin i u drejtojshin të huejë, sidomos Vatikani e Franca (Gjomarkajt ishin famuj të Napoleonit III e të qeverris frenge që në pagzim të çdo djali të posalindun dergojshin dhurata n'Orosh), Ai vetë asnjë herë s'e ka perdorë. Qeshte: — M'u quejtë princ duhen begati, t'ardhuna të majme e pallate e kual e karroca. — *Kapidan i Mirditës* nënshkruhej. Kam përshtypjen se titulli *Kapidan'i Mirditës* (me kuptim prisi, udhëhjekës luftarak) në mende të Tij vlente shumë më tepër se ai i një princit të cilitdo vis të botës. Ushqente idë

shum të naltë për zanafillen e vet shqiptare dhe ai titull fisnikije, buruc e rrjedhë nga rrethanat e historisë vëndase që e dallonte në mes gjindes s'onë, kishte për Të çmim më të madh se titulli « princ » në përdorim ndër të huej.

REFORMAT E KAPIDAN GJONIT

Nuk fosilizohej në një mendesë mesjetare, si mendonte ndokush dhe si i u shkarkuen disa pa i a njoftë menden e veprat. Besnik i traditave po, por i atyne me frymë të shëndoshtë: kuptonte nevojën e kohës së re dhe pa ngurrim reformoi nejet e Kanûnit tepër të vjetrueme. Shqiptarët gjithmonë janë rregullue në punën e mbarshimit të vendit mbas frymës demokratike edhe para Revolucionit francez. Kurr populli i ynë nuk u nda në klasa shoqnore. Privilegjet shoqnore i sollën të huejët. Shqiptarët e maleve, ku mbet i paprekun shpirti gjenuin i fisit, punët e përgjithëshme i rrahshin e i zgjidhshin ndër kuvende. Barasija në mes Malsorvet është e plotë. Kapidani s'ishte tjetër veç një *primus inter pares*. Pa kuvend nuk vendoste ndrrime.

Me 1937 Kapidan Gjoni (shif *Hylli i Dritës* korrik-gusht t'atij vjeti, faqe 417-18) mblodhi e kryesoi në Mirditë një kuvend Krenësh e Pleqësh për të sjellë ndryshime në disa zakone tepër anakronike. Sekretar n'at mbledhje që Dom Zef Skâna, famullitar i Fandit. Ndodhen pranë si pjestarë nderi pa të drejtë zâni Abati Emzot Gjini edhe Prefekti i Shkodrës Javer Hurshiti. Në shumë rase tjera Kapidani, pa bërë ndryshime, dha një interpretim të pikave të Kanûnit që përkonte me frymën e kohnave të reja. Si të gjithë udhëheqsat mendësquet Ai i jepte randësi shpirtit jo gërmës së ligjit dokesuer.

MARKU E LLESHI

Kapidan Gjoni, i martuem me Zojën Mrika e Gjon Pjetrit, bijë fisnike e shtëpisë së mirnjohun Pervizi nga Kurbini, i fali Zoti gjashtë djelm e gjashtë vajza. Prej tyne sot janë gjallë pesë bija e një djalë në Shqipëri e dy djelm, Ndou e Nikolla, në mërgim.

Kur fati e shtrëngoi Kapidanin me braktisë atdhën e rrethin shtëpijak, nuk i la Mirditasit vetëm. Donte të qindronte Ai vetë me ta. Marku, djali i madh, i a mbushi menden m'u nisë. Kapidani i a lëshoi atij kryeparin edhe shestimin e qindresës. Me Markun u ndal edhe Lleshi.

Si u sollën këta dy deshmorë të Liris, si luftuen e si flijuen jetën e re mbi therore të traditave shëjte të fisit, mbarë Shqipëria e din. Vdekja me ngjyra tragjedi greke të pinjonjvet fatosa të Derës së Gjomarkajvet është e rrethume me shkelqim epopeje. Dishmuen ç'brumë homerik trimash shfaqet hov hov mbi male të Shqipërisë dhe ç'frymë e naltë heroike lëvitte në votër pranë së cilës u rriten.

Shqiptarët e dëjë për këtë emën nuk do t'a harrojnë trimnën krenare të tyre dhe veshtrimin e naltë njerzuer e kombtar që shndritë në të.

Na të mërguemit, që jetuem afër Kapidanit edhe patëm fatin t'a takojmë të thuesh për ditë me vjet rrjesht, do të kemi para sysh fytyrën e Tij me viza bujare të holla e të mprehta ashtu si e shifshim kur, rrethue dashunisht prej nesh, mirrte pjesë në bisedime t'ona. Nuk i biente fjalë në tokë. Vërejtjet që bënte, të matuna e t'urta, zbritshin kuvendimin. Përvoja e fitueme gjatë një jete së vështirë plot tronditje të paprituna melmente bisedën gjithashtu që Ai ndërhynte. Një dëll i lehtë humori, që nuk u mungon burrave të maleve, një kokërr krypë shpotije pa thepa therës i a bënte të shijshem të folurit kur merrte me tregue ndodhina e store të vjetra. Kishte një mbamendje të çuditëshme. Vargje kujtimesh në lidhje me ngjarjet shqiptare shtjelloheshin në kallzim të Tij si rrokela filmash ndër ditë që ishte në qejf.

SMUNDJA MIZORE

Me 1960 u smue. Djagnoza e mjekve që menjherë e disprueme. Nuk i jepshin jetë më se dy-tre muaj. Përkundrazi trupi qëndroi aq sa me çuditë vetë mjekët që e kishin në kujdes. Pat një prapje, mbas 45 ditësh që ndëi në Poliklinikë t'Universitetit të Romës, e këthei në shtëpi të mbesat e vogla t'adhueme, vajzat e Ndout, e për disa vjet tjera vazhdoi jetën e zakonshme. Me 1964 smundja u shfaq përsëri e për dy vjet e dhetë muaj prap mbet i shtruem në spital. Asnjë ankim s'i dël kurr nga goja. Vizituesave, mbasi zënin i a kishte këputë smundja, i flitë me dritë të syve që nënqesheshin me një hije trishtimi në thellësi të minxave. Ishte një nënqeshje që lulzonte nëpër therje të dhimbave. Zotnonte dhimbat e vazhdueshme të smundjes për t'u paraqitë miqvet një fytyrë të këthielltë. Pyette për gjendje të Shqipnís, për veprimtarí të mërgatës. E dinte mirfilli se ishte i dënuem. Besimi i patundun në mirsin e Perendís i a mbante shpirtin të qetë. Pritte burrisht pa u tutë t'imat e fundit. E drita e nënqeshjes në buzë të zbardhueme prej vëjtjeve vinte përherë tue u pakun, por nuk zhdukej. Kaloi në jetë të pasosme n'orën 21,15 të ditës 28 prill 1966, tue i a shtrëngue dorën Ndout, të birin që u kujdesue për Të me dashuní birnore të pashoqe gjatë smundjes së gjatë që i a shkimi dal-kadalë fuqit e trupit, bë asht e lëkurë.

Nonse sosja e stinës së Tij njerzore pritej me sot e me nesër, lajmi i vdekjes mjeroi gjithkëndin tek u përhap.

Do të jesi kujtimi i Tij në zëmrat e miqvet e të dashamirvet si përfaqësuesi i fundëm i një Shqipnie heroiko-patriarkore endë në rriben e rrebesheve të historís më fatakeqe që njofti bota. Duhit shpesh kanë terratisë si tokën e atdheut ashtu shpirtin e burrave që ajo gjinikonte. Por edhe në turr më felgrues të duhinave e në mbërthim të territ më të dendun, vlonte në shpirtin e burrave besnikë të traditës, qoftë edhe t'errsuem nga ndiesi të pështjellueshme, shkasi i ndritëshëm i rilindjes kombtare.

Përsjellja e përmortshëme e Kapidan Gjonit

Të shtundën me 30 prill u zhvilluen salikimet e Kapidan Gjon Marka Gjonit. Trupi i Tij u muer nga Klinika Shën Andrea, në të cilën ndodhej i strehuem në këto kohët e fundit edhe u vndue në koçin mortore mbulue para e mbrapa edhe anash me kunora lulesh. Vetëm farefisi e një tubë miqësh të ngushtë e përsjellshin me makina. Nga periferija e Romës vargari i përmortshëm u drejtue kah qendra shpejt e shpejt edhe arrini te Kisha e Shën Camillo-s në Via Sallustiana, ku pritshin një grumbull dashamirësh e të njoftunsh ardhë me i dhënë Kapidanit përshëndetjen e fundme. Mbrendë Kisha ishte e veshun me pelhurna të murrme në shëj zije. Mbështetë për shtylla shifeshin kunorat e mëdhaja dergue në nderim të të Ndiemit. Një mori gjindjeje, — mbarë kolonija shqiptare e Romës, me pak përjashtime, — dhe një shumicë të huejësh muerne pjesë në ceremoninë fetare. Mesha e dritës u çue nga Famullitari i Shën Camillo-s, i cili në fund e kaditi edhe e bekoj arkivolin dhe shqiptoi lutjet e veçanta për shpirt të të Zhdukunit.

Pjesëmarrja e miqvet italianë qe mjaft e dendun. Shenoheshin ndër tjerë: Shkelqesat Cassiani e Gjeneral Palandri, Prof. Schirò, Zoja Maja Jacomoni në përfaqësi të shojt të smuet, Prof. Gradilone, Dott. La Francesca, Comm. Zanutto, Pio Montanari e tjerë.

Para hymjes qendrore të Kishës, kur trupi i të Ndiemit u vndue në koçin mortore për t'u nisë kah vorrezat, u bâ një prâjë, gjatë së cilës Prof. Ernest Koliqi, mik i vjetër e kumbar i Derës së Gjomarkajvet, mbajti fjalën qi është e botueme po në këtë numer të së përkohëshmes.

Miq e dashamirë e të njoftun i a shtrënguen dorën për krye shëndosh Kapidanavet Ndue e Nikollë Gjomarkaj, dy bijt e të Shuemit qi ndan mërgimin me të. Këtu përsjellja mori fund. Në vorreza shkuen vetëm rrethi familjar e farefisi. Tjerët u shpërndanë, të gjithë me shëje pikllimi në fytyrë.

Kunorat qi mujtem me pá ishin: ajo e shpijarvet, e nipave e të mbesave e disa shumë të mëdhaja dergue nga familiet Verlaci, Shkreli, Zorzoli, Mirakaj, Koliqi e nga z.z. Tahir e Rifat Kolgjini, Asllan Zeneli, Iljaz Kraja, Lazër Çupi. Një kunorë e porositun nga Grupi i Blokistavet të Belgjikës arrijti mâ vonë. Nga Italianët pamë kunora të dergueme prej Colonnello Caracciolo - Feola - Mazzoli. Lypim të falun në qoftë se na ka shpëtue ndonji emën dërguesi lulesh.

TELEGRAMME NGUSHULLIMI QI U ERDHEN NDOUT
E NIKOLLIT GJOMARKAJ

«Vdekja e Mikut t'onë shekulluer Gjon Gjomarkaj na tronditi thellësisht. Unë e Mbretnesha Ju ngushullojmë si Juve ashtu Pjestarët e Familjes. Përendija t'Ju apë durim».

(Nga Madrid-i)

LEKA I

* * *

«Assicurando suffragi per anima Principe Mirditi Gjon Markagjoni invio sentite condoglianze alla comunità albanese e alla Famiglia compianto Defunto».
(Prof. Koliqit: nga Roma)

CARDINALE ANTONIUTTI

* * *

«Impossibilità intervenire triste cerimonia invio di cuore più affettuose condoglianze».
(Nga Roma)

FRANCESCO JACOMONI

* * *

«Z. Ndue Gjomarkajt:

Të prekun thellësisht për humbjen e madhe që keni pësue me vdekjen e Atit burrit dhe mentarit të shquem të Malcís shqiptare në emën Komitetit «Shqipnija e Lirë» dhe Kolegje t'uej të Komitetit Ju shprehim ngushullimet më të ndieshme».

(Nga New York-u)

REXHEP KRASNIQI

* * *

«N'emër të Organizatës Kombëtare Lëvizja e Legalitetit dhe t'imin U shfaqim keqardhjen më të thellë për vdekjen Eksponentit Blokut Kapidanit Gjonmarkaj Ushtarit të palodhur Atdeut».
(Nga New York-u)

SELIM DAMANI

* * *

«N'emën të Lidhjes së Përzëndit dhe të Kosovarvet në përgjithësi Ju shprehim ngushullimet më të ndieshme për humbjen e Babës s'uej».
(Nga New York-u)

Sekretari: ISMET UKE SADIKU

* * *

«Humbja e Plakut patriot e symbol i Bajrakvet e malevet të Veriut na preku thellësisht. Ju ngushullojmë Familjen e Miqët».
(Nga New York-u)

Grupi i Resistencës Shqiptare
MITAT F. DINE

«Antarët e Organizatës Balli Kombtar të prekun thellësisht për vdekjen e Atit t'uej të shtrëjtë Ju paraqesin ngushillime të përzëmërta».

(Nga New York-u)

Sekretari i Përgjithshëm i OBK
QAZIM EMRA

* * *

«N'emën të Blokistëve ngushillimet më të ndieshme për vdekjen e Babës».

(Nga New York-u)

MELYSHI - ASHTA - ÇUNI

* * *

«Ngushillime të përzëmërta për vdekjen e Gjon Marka Gjonit».

(Nga Bruxelles-i)

Për Grupin Blokist të Belgjikës
RROK MALOKI

* * *

«Pukasit e New York-ut marrin pjesë thellësisht në humbjen e Babës s'Uej Kapidan Gjon Markagjonit».

(Nga New York-u)

* * *

«Gjith Qendra Ndërkombtare për Studimet Shqiptare edhe në përfaqësi t'Instituteve tjera arbreshe të Sicilis marrin pjesë me pikllim në zën e madhe të Derës Gjomarkaj dhe i luten Zotit qi kjo të shofi dit më të mira e më të lulzueshme bashkë me gjith popullin fisnik të Mirditës e të Shqipërisë».

(Nga Palermo)

PETROTTA - VALENTINI - GURAKUQI

* * *

«Lajmi i idhët i vdekjes të Mikut t'em shumë të dashtun Gjon Marka Gjonit më tronditi thellësisht. Bashkohem në zën e madhe shpirtnisht me Juve. Zoti t'Ju apë durim».

(Nga Madrid-i)

HYSEN SELMANI

* * *

«Ngushulloy marr pjesë me idhënim për vdekjen e Kapidan Gjonit. Ju shëndosh».

(Nga Bruxelles)

MUHARREM BAJRAKTARI

* * *

«Z Ndue Gjomarkajt:

«Zotnis s'Uej dhe Familjes paraqesim ngushillimet t'ona të thella».

(Nga London-i)

MARIA SELMA dhe TAJAR ZAVALANI

« Appreso con ritardo la scomparsa di vostro Padre e ne sono rimasto profondamente colpito. Invio a voi e famiglia le mie più sentite condoglianze ».
(Nga Firenze)

ISA NDREU

* * *

« Lajmi vdekjes Babës s'Uej na hidhënoi shumë - Marrim pjesë në zën e Familjes s'Uej ».
(Nga New York-u)

Familja MYFTIJA e XHEMAL LAÇI

* * *

« Pikllueshëm vdekje Kapidanit paraqes përdhimbjet e mija më të ndieshme Ty Nikollit familjevet - Mesha këtu tetë maj ».
(Nga New York-u)

DOM OROSHI

* * *

« Me hidhërim Ju shpreh ngushillime të sigjerta për vdekjen e Babës e Kryetarit të Mirditës ».
(Nga Roma)

BERATTI

* * *

« Tepër të piklluem nga lajmi i idhët i vdekjes së Kapidan Gjonit - Me Të zhdukët një shtyllë e nacionalizmit dhe traditave shqiptare - Tue marrë pjesë në zën t'Uej familjare Ju dergojmë ngushillimet më të ndieshme ».
(Nga Bruxelles-i)

HYSEN PRISHTINA - TAHIR ZAJMI -
RIFAT KOLGJINI

* * *

« Vdekja e Plakut të Maleve t'ona lën shprazëti të thellë n'udhaheqësën e nacionalizmit shqiptar - Tue marrë pjesë n'idhënim Ju dergoj ngushillime miqasore ».
(Nga Bruxelles-i)

SABRI DOMI

* * *

« Ju shoqnoj helmueshëm në humbjen e Babës - Dritë Atij dhe jetë të gjatë për çka ka lënë ».
(Nga Istanbul)

TAHIR KOLGJINI

* * *

« Nel dolore perdita Vostro Padre mie sentite condoglianze ».
(Nga New York-u)

SAID KRYEZI

* * *

« Me zëmër të pikllueme ngushulloj vdekjen e babës t'and që është humbje e madhe jo vetëm për Jue e për në por për gjithë nacionalizmin shqiptar ».
(Nga Bruxelles-i)

PRENK PERVIZI

Vëllanzëvet Ndue e Nikollë Gjemarkajt u kanë ardhë edhe tjera telegrame. Nga Shtetet e Bashkueme t'Amerikës prej zotnive të tyre: Ndue Perpepaj, Ded Pjetërnika, Bardhok Ndreu, Vendresha, Dr. Hamdi Oruçi, Haki Jonuz e Elez Ndreu, Ndreu Kaziu, Nikoll Shkoza, Gjok Dragusha, Gjon Mark Çupi, Familja Nik Kajtazi, Mexhit Dibra, Lem e Lec Koliqi, Zef Luka, Pjerin Shkreli, Gac Gurakuqi, Toni Leka.

* * *

Nga Anglia: Lazër Çupi.

* * *

Nga Belgjika: Beqir Rroji, Nik Gjeto Daka, Arif Zekollari.

* * *

Nga Jugosllavia: Familja Kajtazi.

* * *

Nga Austria: Familja Koka.

* * *

Nga Gjermania: Prof. Martin Camaj, Hil Topalli, Gjon Gjinaj, Ahmed Demi, Bardhok Shkurti.

* * *

Nga Roma: Neki Libohova, Generale Amedeo Vergé e famiglia, Ottolino-Marinelli, Famiglia Di Porto, Famiglia Del Monaco, Famiglia Fabiano, Erminia Battisti-Melgushi e famiglia.

* * *

Nga Palermo: Hanni e Gilbert Gurakuqi, Famiglia Bojaxhiu, Guzzardo.

Kanë dergue letra përdhimbtimi: Zz. Ing. Xhafer Deva, Prof. Rexhep Krasniqi, Nikoll Melyshi, Shukri Biçaku, Dr. Spiro Muka, Albert Curani, Prof. Zef Nekaj, Ymer Doda, Ndue Lala, Nos Qirjaku, Prënk Pervizi, Ndue Melyshi, Dul Rroji, Gjergj Koka, Gjon Marka Gjini, Gjetë Gjonaj, Haki Ballanca, Zef Suti, Pashk Margjona, Lec Shllaku, Adem Tafani, Qani Lesk Tatzati, Ahmet Sata, Hetem Zeqiri, Kamer Alla, Bardhok Doda, Daut Elez, Kol Froka, Lem e Lec Koliqi, Gjin Mirakaj, Ded Gjini, Lazër Çupi, Viktor Koliqi, Gjok Preng Markaj, Marka Zefi, Dod Frroku, Ndreu Kola, Prend Ndue Çupi.

Tjera letra vazhdojnë të vijnë me vonesë të shkaktueme nga greva e post-përndasavet që nga gjymta e majit e në fillim të qershorit pengoi në Romë shpërndamjen e rregullt të korrispondencës

Për Kapidanin e Mirditës Gjon Marka Gjonin

(Fjalë e mbajtur në vorrim të Tij nga ERNEST KOLIQI)

U përpj nga Hijet e Mëdhaja të Vdekjes edhe ky Burrë në të cilin gjatë shtegtimit mbi këtë dhë u shfaqen të skalituna vetit më tipike të gjakut t'onë shqiptar. Jetoj në një kohë kapërcimi prej një epoke në tjetrën e cila shkaktoi përleshje të frigueshme në mes dy botash në kundërshtim: një botë që prendonte e që ndër në kishte ngjyra heroiko-patriarkore e një botë mendimesh të hovshme, që synonte në vrull të saj me shqymbë çdo shënj kalese para se me përtri mbi baza të reja jetën e njerzimit. Shka ishte vërtet e meritë për etent e gjyshit, u qujt papritmas e mbetë mun faj për breznit e reja.

Kapidani i Mirditës u përshkue në mes këtyne lagjeve në luftim tue besue ngultas në vlerat e përvojës stërgjyshore, i bindun se vetëm ky trashigim i urtis së lashtë qet në breg të mirqënjes në këtë jetë në datsh një njeri, në datsh një votër shtëpijake, një rreth shoqnuer, një komb.

Shum kush, tue plegnue mbi punët shqiptare, harron se populli i ynë, deri para disa dheta vjetsh, gjallitë i kredhun e i zhytun në një mendësi anakronike e në kushte shoqnore gadi të thuesh mesjetare. Përrjashtimet ishin të rralla. Animirë: mos t'i dënojmë tepër ngutëshëm at mendësi e veprimtarin n'ato kushte, sepse një popull, që rrethënat historike e shtrënguen të jesin i pazhvilluem e i ngujuem

në parime të thjeshta trashigie nga të Parët, pikënisht në një botë-kuptim anakronik gjën murojën e substancës së vet ethnike. Deri sa kultura e njimendët mos t'a pajisi at popull me ndërgegje kombtare, është instinkti ethnic bashkë me thalbin e dokeve jetike që i a mprojnë fizionomin e vërtetë, e cila e dallon nga popujt e tjerë.

Dera e Kapidanavet të Mirditës, në nâm e në zâ në krejt gadishullin balkanik e tutje, që një arkë e shugurueme ku u ruejten ndër shekuj normat kanunore d.m.th. esenca heroiko-patriarkore me palc të çmueshëm njerzuer, esencë që e shpëtoi rodin e Shqiptarit nga zvetnimi e çoroditja. Ai visar dokesh ishte dikur pajë e mbarë kombit, mandej kushtet e egra të zotnimit azjatic erdhen tue i a ngushtue qarkun e ndikimit edhe tue e kufizue në malet e Shqipnís. Fryma e vjetër e ligjve dokësore, ku më pak ku më shumë, lëviti e rrahi pajadâ në gjak të Shqiptarit e shtrime në krejt tokën e atdheut dhe ngjeti kudo që njerz rodi shqiptar u shpërngulen. Studjuesa e hulumtuesa të huej në Kanûn të Malevet hetuen substancën më të kulluet të fisit arbnuer dhe patentet e fisnikís së tij shumë të lashtë indoeuropjane.

Kapidan Gjon Marka Gjonin, Burrë i gdhënnun një cope në curr t'ashpër të landës s'onë rracjale, përfaqësoi traditën autoktone më të pikatun. Në të u mishnue shembullisht burrnija e njerzija e rracës.

Mbas dekës së t'et, si i erdh rendi me marrë mbi vete mbas zakonit qindavjeçar të drejtën e prîjes, doli në shkenën politike me

qellim të prëm t'ushtrojë detyrët e të drejtat qytetnore në suazë t'interesave të përgjithëta kombtare. U ndesh në pengime t'egra sepse një palë njerz, që na u paraqiten si Shqiptarë vetëm atëherë kur u sosen mundësitë e sundimit nën një emën tjetër, kujtojshin se pamvarësia e kombit u ep shteg të zhgattrrojnë edhe shka kursei pa zhgattrrue Turqija largpase e Sulltanave në vllug ngadhënjyes të fuqisë së vet. Mjerisht tepër shpesh etiketa e patriotizmit shpërdoret për të mbulue qellime që me patritotizëm s'kanë të bëjnë kurrnjë grimë. Kapidan Gjoni, i përshkuem në shpirt nga urtija e vërtetë shqiptare, kurr nuk u ngjue me vullnësë të vet, as kur rrethënat mund i a ligjojshin disë një të tillë ngujim, në qendrime të dâmshëme për vëllaznimin kombtar.

Ai, si të Parët e tij zâmëdhej, me nejet m'a shëjte shqiptare — e kam fjalën te kumbarinat flokësh, te vëllamja a vëllaznimi nëpër të pîm të gjakut, te krushqit nëpër mjet çikash të marruna e të dhânuna — u lidh e u besatue me njerz dyersh e krahinash të largta, pa dallim feje a zânafillje klanesh. Kanûni e mësonte m'u bashkue e me vû në veprim mjetet ndërmjetsije pajtuese ashtu si i shënjonte urtija e vjetër që përmbledhet në nejet e tij.

Njerzit duhet t'i peshojmë në qark dokesh e në mendësi të rrethit shoqnuer nga i cili burojnë e mbas parimit gjikues që ata përdorin me ndâ të mirën prej së keqes, përndryshej biejmë në gabime të dâmshëme që ia turbullojnë ndërgjegjen kombtare të rijvet e cenojnë vëllaznimin shqiptar.

Na, që patme fatin me nxânë pak shkollë e me ndjekë ndër libra ngjarjet historike të popujvet të botës, do të tregojshim ngushtësi mendjeje po të hËjshim me gjikue në dritën e një vetedije shoqnore të përsosun veprimtarin e breznive që rrahen para nesh, në kohna krejt tjera, shtigjet plot pusina e rrezeje të kësaj bote.

Kapidani i Mirditës, si shumë tjerë burra të shquem gjakut t'onë, shifte idealin e një Shqipnije së lirë nën prizmin e përftimeve të lashta kanunore. Shqipnija e ândrrueme prej Tij nuk ishte ndoshta as e përparueme as e zhdrivillueme në degën ditunore e n'ashtuqytunin qytetnim mekanik: Ai mendonte një Shqipni pa ngjyra romantike e prarime idësh moderne, një Shqipni të thjeshtë e burrnore, të mbështetun mbi besë e ndër, mbi shëjtni të mikpritjes dhe mbi krenin e ëmnit shqiptar. Po a nuk âsht ky grumbull ndiesish themeli i një Shqipnije së vërtetë? Kultura, përparimi, zhvillimi në të gjitha degët e jetës qytetare janë stoli e kotë po nuk u shartuen në trunk të këtyne ndiesive themelore. Do të kishim, si sot mjerisht kemi, një Shqipni me maskë shqiptare por jo me shpirt shqiptar.

Prej humus-it m'a të kulluet autokton ushqehej mendja e zëmra e Kapidanit, që na këtu u tubuem sot të përshëndesim për të fundmën herë. Jeta e tij u end me fije t'arta e të murrme ashtu si edhe pelhura e jetës shqiptare paraqitet në histori me ternim hijesh e dritash. Por në Kapidanin dritat vezullojnë me shkëndija lavdije bujare dhe hijet, po i pat, lëshojnë shkrepitima epopeje.

Dera kreshnike e Tij jetoj e lirë ndër shekuj. Pranoi vobeksin e veçimin për mos me i u shtrudhunës e cenimit të pajës stërgjyshore. E Ky vetë tash së fundi doli në dhë të huej për me ruejtë nderin e

lirin. Por nuk e braktisi gjinden e vet. Dy djelm e tij, — pinjoj të rritun në traditën më krenare arbnore — Markun e Lleshin, i la me ndë fatin me popullsi që në Derë të Kanûnit njihte burimin e sundimit dhe njëf murojen e nderit të fisit. E Marku e Lleshi, tue përtrë trimnët e të Parvet fatosa, vulosen me gjakun e tyne rinuer kultin e dokeve më të çmueshme shqiptare dhe dishirin e liris që rreshkë shpirtin e çdo biri të vërtetë të dheut të shqipeve.


Njerzit janë mishit e gjakut dhe biejnë shumë lehtë në gabime. Kapidan Gjoni e pat për parim sjelljen mbas drejtësis ashtu si e caktojnë më parë Ungjilli e, fill mbrapa, Kanûni i Malevet. Edhe në pastë gabue ndoj herë padashtë, gabimin e lau me vujtje të paprëme, me një varg fatkeqsish dhe me therorzime pikllimplote.

Me Të sosit një epokë. Epoka e ré, e cila po lindet në mes tymtash të denduna, dhashtë Zoti që të zhvillohet, edhe në pajisje të përparimeve moderne, pa dalë nga hullija e vërteteve shqiptare që cilësuen Prisin e Mirditasvet.

Të përulim kryet para këtij trupi në përshëndetjen e fundme. Shpirti është tashti para të Naltit Perendi, në mirsin e pambarueme të Cilin ngultas besoi. E shpresoj se Perendija, tue i a njoftë ndiesit më t'ima të shpirtit, ka me vë në kandar gjikues pikllimet e mëdhaja që i a shporuen zëmrën në ket jetë edhe ka për t'a pranue në mbretin e qiellvet si dalzotës i fës e i idealit kombtar të Skanderbegut.

Kujtimi i Tij, i rrethuem edhe me dritën e flijes heroike të djelmvet mbi therore të Liris shqiptare, ka me mbetë gjallë deri në kohnat më të vona në lahutat që këndojnë lavdën e vërtetë të kombit.

Dritë i baste shpirti! Pushoftë në paq të Perendis pranë të bijvet fatosa!



MIRDITË OUTFOSTS.